

Shërbimet e DMH Për të Rritur

SHËRBIMET	PËRSHKRIMI
Sistemi i Pacientëve të Shtruar/ Kujdesit të Vazhdueshëm	Institucione psikiatrike për pacientë të shtruar të operuara nga DMH: dy spitale psikiatrike; njësi psikiatrike në dy spitale të shëndetit publik; pesë qendra komuniteti të shëndetit mendor që promovojnë trajtimin, rehabilitimin dhe rikuperimin.
Shërbimet Klinike për të Rritur në Komunitet (ACCS)	ACCS është një shërbim gjithëpërfshirës, i fokusuar në aspektin klinik, që siguron ndërhyrje klinike dhe mbështetje nga moshatarët, shoqëria dhe familja për të mundësuar dhe lehtësuar angazhimin, për të mbështetur funksionimin dhe maksimizuar stabilizimin e simptomave dhe vetë-menaxhimit e individëve që jetojnë në ambientet që u ofrohen për t'u strehuar. Për më tepër, ACCS ofron një gamë opsionesh strehimi nga ofrues shërbimesh, p.sh., përgatitje trajtimi për të asistuar individët të zhvillojnë aftësi, të krijojnë mbështetje dhe burime natyrale për të jetuar me sukses në komunitet.
Shërbimet e Lehtësimit	Shërbimet e Lehtësimit sigurojnë shërbime afatshkurtra komuniteti klinike dhe rehabilituese që i mundësojnë dikujt të jetojë në komunitet në mënyrë sa më të plotë dhe të pavarur. Shërbimet e Lehtësimit sigurojnë mbështetje që i asistojnë njerëzit të ruajnë, hyjnë apo kthehen në situata të përhershme banimi në ambiente fikse apo të lëvizshme (në shtëpinë e personit apo ambiente të tjera komuniteti).
Programi i Trajtimit Komunitar Integruar dhe Gjithëpërfshirës (PACT)	PACT përdor një qasje ekipi multi-disiplinor për të siguruar mbështetje të menjëhershme dhe afatgjatë, trajtim psikiatrik në komunitet, punë dhe mbështetje në rrugëtimin e rikuperimit dhe shërbime rehabilitimi në mjedisin natyral të individit që janë në dispozicion 24/7.
Klube sociale	Shërbimet e Klubeve Sociale janë shërbime rehabilitimi psiko-sociale që ofrojnë mbështetje përmes një qendre komunitare në të cilën individët janë anëtarë. Klubet sociale asistojnë njerëzit të cilëve u jepet shërbimi të njohin pikat e tyre të forta, të zhvillojnë objektiva, të përmirësojnë aftësitë që njerëzit kanë përcaktuar si të nevojshme për të jetuar, punuar dhe mësuar, dhe të marrin pjesë plotësisht në komunitetet e tyre.
Komunitetet e Rikuperimit Përmes të Mësuarit (RLCs)	Komunitetet e Rikuperimit Përmes të Mësuarit (RLCs) janë rrjete njerëzish me të njëjtat përvoja ku ata mund të ndihmojnë veten dhe gjejnë mbështetje, informacione, referime dhe përkrahje nga njëri-tjetri. Dyert janë të hapura për të gjithë njerëzit që po përjetojnë vështirësi me shëndetin e tyre mendor.
Menaxhimi i Rasteve nga DMH	Shërbim shtetëror që vlerëson nevojat, zhvillimin dhe monitorimin e planifikimit të shërbimit, referimin e shërbimit dhe koordinimin e kujdesit dhe mbështetjen nga familja/ofruesi i kujdesit.

Shërbimet Mjeko-Ligjore	Sigurojnë vlerësime dhe konsultime mjeko-ligjore të shëndetit mendor për individë të përfshirë në sistemin gjyqësor penal; mjekët e caktuar nga gjykata veprojnë si ndërlidhës për personelin e gjykatës në lidhje me çështje të shëndetit mendor në sesione për të rritur dhe për rinj.
Shërbimet për të Pastrehët	Shërbimet e Mbështetjes për të Pastrehët u shërbejnë personave të rritur që janë të pastrehë, shumë prej të cilëve janë kronikisht të tillë; të cilët janë apo besohet se janë të shumë të sëmurë mendërisht apo me shqetësime emocionale. Këta individë jetojnë në streha, në rrugë dhe në vende të tjera që nuk janë të përshtatshme për të banuar, si parqe, nën ura dhe rrugica. Shërbimet e Mbështetjes për të Pastrehët identifikojnë dhe angazhojnë individët që janë të sëmurë mendërisht dhe të pastrehë, me qëllimin kryesor për t'i lidhur këta individë me shërbimin e përshtatshëm, përfshi edhe sistemin e shërbimit të DMH. Tri llojet e Shërbimeve të Mbështetjes për të Pastrehët përfshijnë: Ofrimi i Ndihmës dhe Angazhimi, Stabilizimi dhe Strehimi i Pari. • Ofrimi i Ndihmës dhe Angazhimi - o Këto shërbime, që sigurohen nga Ekipi që Ofron Ndihmën, fokusohet në kontaktin në komunitet me individë që janë të pastrehë, në përpjekje për t'i angazhuar dhe për të lehtësuar dhe mundësuar referimet për trajtim esencial, përfshi shëndetin e sjelljes dhe kujdesin parësor, shërbimet e punësimit, strehimin dhe asistencën për të aplikuar për përfitime që mund t'u takojnë. Shërbimet përfshijnë angazhimin, vlerësimet, ndërhyrjen në raste krizash, informacionet dhe referimin. • Stabilizimi - o Shërbimet e Stabilizimit– Dy modele shërbimi: Streha e Sigurt dhe Streha e Diagnozës së Dyfishtë, të dizenuara për t'u siguruar të pastrehëve akses në strehim të sigurt dhe të qëndrueshëm, shërbime të DMH dhe shërbimet të tjera komuniteti, përfshi akses në shërbimet e shëndetit mendor dhe fizik. • Strehimi i Pari - o Shërbimet e “Strehimi i Pari” kanë 2 modele shërbimi: Trajtimi Gjithëpërfshirës dhe Parandalimi i Përsëritjes (ATARP) dhe Programi i Opsioneve të Strehimit (HOP I dhe HOP 2) janë hartuar për të ofruar shërbime mbështetjeje për strehim dhe të menaxhimit të marrëdhënies së qirasë për individë të autorizuar nga DShM të cilët janë të pastrehë.